

Vendim nr. 168 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 15 (M) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: MITHAT DERVISHI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-242, datë 09.02.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka qenë duke u gjykuar çështja civile nr. 2277, ku si palë paditëse ka qenë kërkuesi dhe palë e paditur shoqëria “Kurum Internacional” sh.a. Gjatë gjykimit të çështjes përfaqësuesi i kërkuetit ka ngritur pretendimin se firma e vendosur në aktin “kërkesë” të datës 13.01.2016, drejtuar palës së paditur, nuk ishte vendosur

nga kërkuesi dhe ky akt përbënte dokument të falsifikuar. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan (gjyqtarja I.M.) ka depozituar kallëzim penal për të hetuar në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat e pretenduara në lidhje me emrin dhe nënshkrimin në këtë dokument.

2. Në lidhje me këtë kallëzim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur para asaj gjykate kërkesë për pushimin e çështjes penale për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP).

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2661/70, datë 11.01.2021, ndër të tjera, ka vendosur: “Kthimin e akteve [...] Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke urdhëruar plotësimin e hetimeve [...]”. Pas kryerjes së veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka paraqitur përsëri për shqyrtim kërkesë për pushimin e çështjes penale për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, sipas kriterëve të përcaktuara nga nenet 329/a dhe 329/b të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1194, datë 18.10.2021, ka vendosur: “Kthimin e akteve [...] Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke urdhëruar përsëri plotësimin e hetimeve [...]”. Pas plotësimit të hetimeve të urdhëruara nga gjykata, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka kërkuar sërish nga gjykata pushimin e çështjes penale.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2131/677 (13-2022-3357), datë 27.06.2022, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pushimin e çështjes penale [...], për shkak se nuk provohet kryerja e veprës penale, si dhe fakti nuk përbën dhe nuk parashikohet si vepër penale.”. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

6. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2022-1429 (260), datë 29.09.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2131/677 (13-2022-3357), datë 27.06.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-242, datë 09.02.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Ndaj këtij vendimi, në datën 31.05.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e tij. Ky ankim është plotësuar në datën 06.06.2023, sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit janë bazuar në akte procedurale të pavlefshme, për arsye se eksperti Sh.Xh. ka qenë në kushtet e përjashtimit. Ky fakt nuk është marrë në vlerësim/shqyrtim dhe nuk është arsyetuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në rekurs është ngritur pretendimi se kërkuesi, në cilësinë e viktimës në këtë procedim penal, nuk është njohur me aktet procedurale të organit të akuzës dhe materialet hetimore sipas kritereve të përcaktuara nga KPP-ja. Ky pretendim nuk është marrë në shqyrtim/vlerësim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe nuk i është dhënë përgjigje e arsyetuar në lidhje me bazueshmërinë në themel. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs. Nga tetë shkaqet e rekursit, të cilat janë renditur në pjesën hyrëse të vendimit, Kolegji Penal u ka dhënë përgjigje vetëm dy prej tyre. Rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, por megjithatë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

8.2. *Cenimi i parimit të kontradiktoritetit, së drejtës së mbrojtjes efektive dhe së drejtës për t'u njohur me aktet procedurale dhe materialet hetimore*, pasi atij nuk i janë njoftuar aktet procedurale dhe veprimet hetimore të kryera nga organi i akuzës. Mosnjoftimi i tyre përbën shkelje të rëndë të legjislacionit procedural penal. Në seancën e datës 27.06.2022, pa u njohur me aktet hetimore, gjykata e ka zhvilluar procesin pa praninë e tij, për shkak se nuk ishte thirrur nga sekretaria gjyqësore, edhe pse ai dhe mbrojtësi i tij ishin në ambientet e gjykatës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale,

mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në rastin konkret kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

11. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohe vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se kërkuksi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pasi i ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë plotësohet edhe ky kriter.

13. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e tij është i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i datës 09.02.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 31.05.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

14. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuksi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës së mbrojtjes efektive dhe së drejtës për t’u njohur me aktet procedurale dhe materialet hetimore. Në lidhje me këto pretendime ai ka argumentuar se nuk i janë njoftuar aktet procedurale dhe veprimet hetimore të kryera nga organi i akuzës dhe mosnjoftimi i tyre përbën shkelje të rëndë të legjislacionit procedural penal. Gjithashtu, ai ka parashtruar se në seancën e datës 27.06.2022, pa u njohur me aktet hetimore, gjykata e ka zhvilluar procesin pa praninë e tij, për shkak se nuk ishte thirrur nga sekretaria gjyqësore edhe pse ai dhe mbrojtësi i tij ishin në ambientet e gjykatës.

15. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se roli i Gjykatës nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron ajo nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më lart, lidhur me argumentet e kërkuessit se nuk është njohur me aktet procedurale dhe materialet hetimore, pasi ato nuk i janë njoftuar nga organi i akuzës, Kolegji vëren se ai nuk ka arritur t'i ngrejë në nivel kushtetues, duke mos arritur të vërtetojë cenimin e procesit të rregullt ligjor në ndonjë prej aspekteve të tij. Gjithsesi, Kolegji konstaton se ai i ka pasur të gjitha mundësitë të dëgjohet në të gjitha shkallët e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ku ka parashtruar çështjen e tij, duke realizuar të drejtën e mbrojtjes dhe duke marrë përgjigje të arsyetuar prej gjykatave.

17. Ndërsa, për sa i përket argumentit tjetër të kërkuessit se gjykata e shkallës së parë e ka zhvilluar procesin pa praninë e tij, për shkak se nuk është thirrur nga sekretaria gjyqësore, edhe pse ai dhe mbrojtësi i tij ishin në ambientet e gjykatës, Kolegji vëren se këto fakte nuk vërtetohen në nivel kushtetues. Kolegji thekson se i përkiste kërkuessit të tregonte kujdesin e duhur për të siguruar praninë e tij në seancën gjyqësore, për sa kohë që ai është njoftuar dhe ka marrë dijeni në formën e duhur për zhvillimin e saj. Gjithashtu, Kolegji konstaton se kërkuessi nuk ka pretenduar mungesën e njoftimit të duhur për datën e zhvillimit të seancës, për rrjedhojë mungesën e marrjes dijeni për këtë datë dhe për zhvillimin e gjykimit, si dhe nuk ka pretenduar se seanca është zhvilluar në një moment (datë dhe orë) të ndryshëm nga ai i shpallur, çka mund ta vendoste atë në pamundësi për t'u paraqitur në kohën e duhur. Për këtë arsye, këto pretendime të kërkuessit nuk mund të merren në shqyrtim.

18. Për sa i takon pretendimit të kërkuessit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të parashikuar nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës, vërehet se ai *prima facie* hyn në juridiksionin e Gjykatës, për rrjedhojë do të shqyrtohet në vijim.

B. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuessi ka pretenduar se vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit janë bazuar në akte procedurale të pavlefshme, për arsye se eksperti Sh.Xh. ka qenë në kushtet e përjashtimit. Ky fakt nuk është marrë në vlerësim/shqyrtim dhe nuk është arsyetuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në rekurs është ngritur pretendimi se kërkuessi, në cilësinë e viktimës në këtë procedim penal, nuk është njohur me aktet procedurale të organit të akuzës dhe materialet hetimore sipas kriterëve të përcaktuara nga KPP-ja. Ky pretendim nuk është marrë në shqyrtim/vlerësim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë dhe nuk i është dhënë përgjigje e arsyetuar në lidhje me bazueshmërinë në themel. Sipas kërkuessit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura në rekurs. Nga tetë shkaqet e rekursit, të cilat janë renditur në pjesën hyrëse të vendimit, Kolegji Penal u ka dhënë përgjigje vetëm dy prej tyre. Rekursi përmbante shkaqe nga ato të

parashikuara nga neni 432 i KPP-së, por megjithatë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij.

20. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjithashtu, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit, është tregues i faktit se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji vëren se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në pjesën hyrëse të vendimit të tij ka pasqyruar shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi dhe pas marrjes në shqyrtim të tyre ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit përmbush standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Sipas tij, gjykata e apelit ka arsyetuar drejt dhe në mënyrë konçize e shteruese, në raport me ligjin procedural penal, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Më tej, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

23. Bazuar në sa më sipër dhe referuar standardeve kushtetuese, Kolegji çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi arsyetimi i kufizuar është tashmë i konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij, i është përmbajtur standardit të arsyetimit sipas jurisprudencës kushtetuese, i cili analizohet rast pas rasti, sipas kontekstit të çdo çështjeje konkrete. Për

rrjedhojë, pretendimet e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të haptazi të pabazuara.

24. Si përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.